



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P.797/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.12.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” meNr. REF-34123-08-22-2019, me objekt : “Ruajtja me polici private të objekteve të KESH sh.a (Tiranë, Vlorë Durrës”- Marrëveshje Kuadër –me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 36 muaj” me fond limit 57.748.099 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.09.2019 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjetiko Shqiptare).

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Anakonda Security” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi -2K” sh.p.k.& International Security Albania”sh.p.k.
Rruga e Kavajës, pranë hyrjes kryesore të fabrikës “Birra Tirana”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

KESH sh.a (Korporata Elektroenergjetiko Shqiptare)
Blloku “Vasil Shanto, P.O. Box 259/1, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorine çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.08.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” meNr. REF-34123-08-22-2019, me

objekt : “Ruajtja me polici private të objekteve të KESH sh.a (Tiranë, Vlorë Durrës”- Marrëveshje Kuadër –me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 36 muaj” me fond limit 57.748.099 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.09.2019 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjetiko Shqiptare).

II.2. Në datën 30.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 15.10.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---|----------------------------------|
| 1. “Semani”sh.p.k. | pa ofertë ekonomike |
| 2. “Trezhnjeva”sh.p.k. | pa ofertë ekonomike |
| 3. BOE “Mandi -2 K” sh.p.k.
& “I.S.A” sh.p.k. | 47.390.238,57 lekë, skualifikuar |
| 4. BOE “Anakonda Security”sh.p.k.
& “Toni Security”sh.p.k. | 47.390.238,57 lekë, kualifikuar |
| 5. “Nazeri 2000”sh.p.k. | 54.645.261,12 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 15.10.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

OE “Mandi 2K” sh.p.k. nuk plotëson kriterin 4 të kapaciteteve teknike 3.3 në të cilin kërkohet: “Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar, jo më pak se 25 punonjës, (punonjës sherbimi, grup te gatshem, Titullar dhe Drejtues teknik te shoqerise). Per te vertetuar kete kriter duhet te paraqiten Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik-Gusht 2019”, pasi OE “Mandi 2K” sh.p.k nuk ka paraqitur Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik-Gusht 2019.

-OE “Mandi 2K” sh.p.k. nuk plotëson kriterin 8 të kapaciteteve teknike 3.3 në të cilin kërkohet: “Operatori ekonomik duhet ë paraqesë një Vërtetim lëshuar në vitin 2019, të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, me anë të cilit të jepet informacion se: Ka Qendër Kontrolli në Njësin Administrative ku ndodhet objekti, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.75/2014” pasi në vërtetimin e policisë së qarkut Vlorë paraqitur nga OE “Mandi 2K” vërtetohet se nuk ka qender kontrolli në Njësin Administrative Vlorë.

- OE “Mandi 2K” sh.p.k., nuk plotëson kriterin 9 të kapaciteteve teknike 3.3 në të cilin kërkohet: “Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 1 (një) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punës. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën

kusht për s'kualifikim" pasi ky operator ekonomik, për punonjësin Bekdash Cukalla, nuk ka paraqitur diplomë bachelor por një diplomë të shkollës së mesme profesionale "Antoni Athanas" në Sarandë dhe, me këto dokument, nuk plotësohet kërkesa për kualifikim. Ndonëse shoqëria tjetër e bashkimit të operatoreve ekonomike "International Security Albania" e plotëson këto kusht, në akt marrëveshjen e bashkepunimit midis dy OE "Mandi 2K" sh.p.k dhe "International Security Albania" nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këto shërbime për të dyja shoqëritë e bashkimit.

II.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, në datën 18.10.2019, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Mandi 2K" sh.p.k. & Internacional Security Albania" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Anakonda Security" sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon se:

[...]Boe "Mandi 2K" sh.p.k. & Internacional Security Albania" sh.p.k., ka marrë pjesë në tenderin me objekt : "Ruajtja me polici private të objekteve të KESH sh.a (Tiranë, Vlorë Durrës"- Marrëveshje Kuadër –me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 36 muaj", ku u paraqitëm ofertën e tyre me datë 23.09.2019. Në datën 15.10.2019 kemi marrë njoftimin nëpërmjet sistemit elektronik, ku KVO-ja n aka skualifikuar me pretendimin për të cilën po paraqesim kundërshtimet tona të argumentuara si më poshtë dhe me dokumentacionin përkatë bashkëngjitur:

Nga KVO-japretendohet se:

- 1. "Mandi -2K" sh.p.k. nuk ka paraqitur listëpagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga Administrata Tatimore.*
- 2. Nuk ka qendër kontrolli në njësinë administrative ku është objekti.*
- 3. Nuk ka në stafin teknik një punonjës të diplomuar në Bachelor për elektronik/telekominakacion /informatik/kompjuterik megatronikë.*
- 4. Përsa më sipër pretendimet nuk qëndrojnë për arsyet e mëposhtme.:*

Mbi themelin e ankimit

Vendimi për skualifikimin e ofertës tonë është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të dhëna nga ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe në kundërshtim me kritret kualifikuese të parashikuara në DST të Miratuara me VKM nr. 914 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". Vendimi për kualifikimin dhe skualifikimin e oevve pjesmarrës në një procedurë prokurimi është një akt administrativ në kuptim të nenit 98 të Kodit të Pr. Administrative. Gjithashtu akti administrativ për njoftimin e kriterëve të kualifikimit të operatorit ekonomik është akt i cili detyruesisht duhet të jetë i sqaruar në kuptim të nenit 100 të Kodit të Pr. Administrative, pasi ky prek interesa të ligjshëm të palës.

Veprim i i mësipërm përveçse është rezultat i një procesi administrativ të kryer në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Pr. Administrative, nuk respekton gjithashtu asnjë nga elementët e përcaktuara në nenet 98 e vijues të këtij kodi përse i takon formës së aktit dhe arsyesimit të tij.

Shoqëria "Mandi -2 K" sh.p.k. paraqet këtë ankesë duke i konsideruar të pabazuara konstatimin e bërë nga KVO-ja në lidhje me dokumentacionin kualifikues të paraqitur nga ne në tender.

Në fakt këto justifikime nuk qëndrojnë për arsye se ne kemi plotësuar me dokumenta të gjitha kriteret e kualifikimit të kërkuara për të cilat japim sqarime të mëposhtme:

Së pari Nga ana jonë në spe është paraqitur vërtetimi për numrin e punonjësve të siguruar sic është kërkuar nga AK-ja me nr. Mesatar punonjësish për 60 veta për tremujorin e fundit Qershor, Korrik, Gusht duke vërtetuar disa herë më shumë numrin e të unësuarave nga sa është kërkuar nga AK-ja , vërtetim ky i marrë në mënyrë elektronike nga sistemi i Tatimeve në e-Albania ku vërtetohet se shoqëria “Mandi -2 K” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim si dhe numrin e punonjësve të deklaruar për cdo muaj. Përderisa vërtetimi është i rregullt dhe me numër punonjësish më shumë se sa ju keni kërkuar do të thotë se është bërë deklarimi i listëpagesave sipas afateve të parashikuara në ligj, si dhe pagesa në bankë për detyrimet sipas urdhërpagesës përkatëse që gjenerohet në sitin e tatimeve.gov.al pas deklarimit të listëpagesës.

Pra ne si operatorë subjekt juridik kemi deklaruar dhe derdhur për llogari të organit përkatës detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe mandatpagesat për të gjithë periudhën e këkuar në dokumentat standarte të tenderit që është periudha e kërkuar.

Në këtë kuptimreferuar dispozitave ligjore të sipërcituara për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitet teknike në lidhje me numrin e punonjësve , në ërputhje dhe në përpjestim me natyrën dhe volumen e kontratës objekt prokurimi, kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ekonomik shoqëria “Mandi -2 K” sh.p.k.

Sqarojmë se qëllimi i ak-së duhet të jetë verifikimi i kapaciteteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Përderisa përmbushja e kapaciteteve të mjaftueshme në rastin konkret fuqia punëtore, dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore provohen me anë të këtyre dokumentave, qëllimi final është realizuar për përmbushjen e këtij kriteri si dhe referuar vendimit KPP-së nr. 13/2013.

Gjithashtu referuar Vendimit 62/2016 ku është e njëjta arsye skualifikimi si në rastin objekt ankimi, ku ndër të tjera citohet se[...] referojmë vendimin[...].

Referuar arsyetimit të KPP-së përsa kohë shoqëria “Mandi -2K” sh.p.k. ka dorëzuar vërtetimin e nr të punësuarve ndërmjet të cilës vërtetohet se subjekti “Mandi -2 K sh.p.k. rezulton se për periudhën deri në datën 19.09.2019 nuk ka detyrime asnjë borxh tatimorë për TVSH , tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjera tatimesh. Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 23.09.2019 ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen e kapaciteteve në rastin konkret fuqia punëtore e shoqërisë “Mandi -2 K” sh.p.k. lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrime të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit. Referomë nenin 53 pika 3 e LPP-së[...].Vendimin nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar nenin 26 pika 8[...]

Në këtë kuptim për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitet e duhura për kontratën dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitete dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Përsa më sipër ju argumentuam se arsyeja e parë e skualifikimit nuk qëndron.

Së dyti;

Arsye e dytë e skualifikimit është se nuk ka qëndër kontrolli në njësinë administrative ku është objekti, kundështojmë këtë arsye si të pabazuar në ligj.

Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron pasi funksionimi i kompanive SHPSF bëhet mbi bazë qarku sipas Udhëzimit nr. 130 datë 05.03.2018 Për funksionimin e SHPSFgërma “d” pika 5 thotë se miratimi i

Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë. Pra funksionimi i subjekteve SHPSF organizohet mbi bazë qarku dhe nuk është e nevojshme të ketë qendër kontrolli në cdo qytet njësi administrative, por mjafton të ketë të miratuar qendrën e kontrollit brenda territorit të Qarkut.

Për sa m'është për kemi plotësuar kriterin pasi shoqëria "Mandi -2K" sh.p.k. ka paraqitur Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit me seli në njësinë administrative Sarandë që është nën juridiksionin e Qarkut Vlorë, ky akt i miratimit i qendrës së kontrollit është bërë nga Drejtuesi i Parë i DPQ Vlorë.

Për sa më sipër argumentuam se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron pasi është e pabazuar në ligj dhe është arsye skualifikimi tendencioze duke cënuar haptazi barazionë në tendera dhe prokurimet publike.

Së treti: Përsa i përket arsyes se nuk ka në stafin një punonjës të diplomuar në Bachelor për elektronik/telekomunikacion/informatik/kompjuterike/megatronike ndonëse Shoqëria tjetër e BOE "I.S.A." sh.p.k. e plotëson këtë kusht, në akt marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorit ekonomik nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këtë shërbim për të dyja shoqëritë e bashkimit.

Përsa më sipër ju sqarojmë se në Akt-Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. 3242rep dhe nr. 1025 kol datë 19.09.2019 e paraqitur në spe në pikën 3 paragrafi 3 citohet shprehimisht se:

Palët bien dakord të bashkojnë kapacitetet teknike, ekonomiko-financiare, administrativo-ligjore me qëllim plotësimin e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor si dhe të realizimit të kontratës së shërbimit në rast shpalljes fitues.

Pra pretendimi i juaj në arsyen e skualifikimit se ndonëse shoqëria tjetër e BOE-së "I.S.A." sh.p.k. e plotëson këtë kusht në akt marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorit ekonomik nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këtë shërbim për të dyja shoqëritë e bashkimit është i pavërtetë dhe i pabazuar në dokumenta.

BOE Shoqëria "Mandi 2K" sh.p.k. dhe shoqëria "I.S.A." sh.p.k. e ka përmbushur këtë kriter pasi sipas përcaktimeve që ju vetë si KVO keni bërë. Për sa më sipër argumentuam se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

Së katërti: Nga vlerësimi i bërë nga KVO rezulton se është kualifikuar oe "Anakonda Security" sh.p.k. kundështojmë kualifikimin e këtij operatori ekonomik pasi nuk plotëson kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 8 nën pika 7 ku kërkohet:

Ka jo më pak se 2 armë brezi dhe 1 armë krahu.

Operatori ekonomik "AnakondaSecurity" sh.p.k. nuk përmbush këtë kriter pasi nuk disponon armë krahu e deklaruar në sistem SIMA të vërtetuar nga DVP Vlorë.

Përsa më sipër argumentuam arsyen se operatori ekonomik "AnakondaSecurity" sh.p.k. duhet skualifikuar.

Së pesti: Nga vlerësimi i bërë i KVO-së rezulton se është kualifikuar operatori ekonomik "AnakondaSecurity" sh.p.k. kundështojmë kualifikimin e këtij oe-je pasi nuk plotëson kriterin 2. Kriteret e vecanta të kualifikimit 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë gërma "b" deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas shtojcës 1/1.

Opearatori ekonomik nuk ka plotësuar saktë deklaratën për paraqitje oferte të pavarur pasi në pikën 6 nuk ka plotësuar gërmën "b" pasi ky operator konkuron si bashkim operatorësh ekonomik në këtë procedurë. Opearatori ekonomik "AnakondaSecurity" sh.p.k. duhet të kishte cekuar gërmën "b" pika 6 tek deklarata për paraqitjet pavarur.

Përsa më sipër argumentuam në zbatim të kërkesave të LPP-së [...] si dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 e ndryshuar dhe DST kërkojmë:

Pezullimin e vazhdimin të procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht.

Rivlerëimin e ofertës të paraqitur nga BOE "Mandi -2K" sh.p.k. & "I.S.A." sh.p.k., kualifikimin e saj.

Skualifikimin e operatorit ekonomik "AnakondaSecurity" sh.p.k.

Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga BOE "Mandi -2K" sh.p.k. & "I.S.A." sh.p.k., [...].

II.6. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor në datën 24.10.2019, me anë të shkresës nr.4379/3 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes ka sqaruar:

[...]Komisioni pasi u njoh me Dokumentat e Tenderit, Dokumentacionin e paraqitur nga BOE "Mandi 2K" sh.p.k & "International Security Albania" sh.p.k dhe pretendimet e tij relaton si me poshte:

Se pari (Ratione temporis): Ankesa eshte paraqitur brenda afatit te percaktuar ne Nenin 63/2 te Ligjit dhe Nenin 78/5 te VKM dhe si e tille pranohet te shqyrtohet nga Komisioni Shqyrtimit te Ankeses.

Se dvti (Legjitimiteti i ankuesit dhe forma e ankeses): Ankesa eshte paraqitur nga personi i interesuar sipas formatit te kerkuar ne Nenin 78/3 te VKM dhe si e tille pranohet te shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses.

Ankimuesi pretendon se skualifikimi i ofertës së tij nga KVO, eshte i pabazuar ne dokumentacionin e paraqitur ne tender.

1. Ne lidhje me pretendimin e ankimesit se ka paraqitur vertetim per numrin e punonjësve të marrë ne menyre elektronike nga sistemi i tatimeve. Sipas ankimesit se ky vertetim ploteson kriterin e numrit te punonjësve te kerkuar ne DT, komisioni relaton:

Ne DT kerkohet qe OE duhet te kete te punesuar jo me pak se 25 punonjes, (punonjes sherbimi, grup te gatshem, Titullar dhe Drejtues teknik te shoqerise). Per te vertetuar kete kriter duhet te paraqiten Listpagesat E-SIG 25 shoqeruar me Formularet e Deklarimit perkates per muajt Qershor-Korrik-Gusht 2019. Ne rastet e bashkimit te operetoreve ekonomike kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesmëarres ne perputhje me përqindjen e pjesemarrjes ne te kundert përbën kusht s'kualifikimi:

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga BOE vuri re se OE "Mandi -2K" ka paraqitur vetem vertetim per numrin e punonjësve dhe nuk ka paraqitur Listpagesat E-SIG 25 shoqeruar me Formularët e Deklarimit perkates per muajt Qershor-Korrik- Gusht 2019, pra dokumentacioni nuk eshte paraqitur ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

Referuar nenit 53 pika 3 e ligjit Nr.9643 date 20.11.2006, i ndryshuar dhe Nenit 66 pika 3 e VKM 914, date 29.12.2014, i ndryshuar ku citohet se KVO vlereson te vlefshme vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit.

Per sa me siper, Komisioni i shqyrtimit te ankeses gjykon se pretendimi ankimesit nuk qendron.

2. Ne lidhje me pretendimin e ankimesit se OE "Mandi-2K" eshte'skualifikuar pa te drejte per mangësinë nuk ka qender kontrolli ne njesine administrative ku eshte objekti pasi-subjektet shpsf oranizohen ne baze qarku dhe nuk eshte e nevojshme te kete qender kontrolli ne (do qytet komisioni relaton:

Ne DT pika 8 e kapacitetit teknik, kerkohet qe, OE te paraqese nje vertetim leshuar ne vitin 2019, nga Drejtoria e Policisë se Qarkut Vlore, me ane te cilit te jepet informacion se: Ka Qender Kontrolli ne njësinë Administrative ku ndodhet objekti ne përputhje me nenin 22 te ligjit nr.15/2014.

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga BOE vuri re se OE "Mandi 2K" sh.p.k ka paraqitur vertetim nga DVP Vlore, ku ne piken 1, te dhena te plota ne lidhje me subjektin, germa (c) shprehet se Subjekti ka miratuar qender kontrolli jashte selisë se DVP Vlorë, Ksamil Parku Kombetar i Butrintit, Sarande vendim nr.83 prot, date 07.05.2018.

Referuar ligjit nr.75/2014, Neni 22 Qendra e kontrollit te SHPSF-se pika 1. "Subjekti i licencuar per aktivitetin e shërbimit privat te sigurise (fizike, ne cdo njesi administrative qe ushtron veprimtarinë, duhet te kete qender kontrolli, ku te tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emetimin e shoqerise" dhe kriterit per kualifikim ne DT.

Per sa me siper, Komisioni i shqyrtimit te ankeses gjykon se pretendimi ankimuesit nuk qendron. 3. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit se OE 'International Security Albania' sh.p.k eshte skualifikuar pa te drejte per mangesine se nuk ka ne stafin e e tij një punonjës te diplomuar ne bachelor per elektronik/telekomunikacioni/informatik/kompiuterike/megatronike komisioni relaton:

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga BOE vuri re se oe "I.S.A." sh.p.k. për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur dokumentacionin për punonjës Bekdash Cukalla.

Përsa i takon pretendimit se në Akt-Mrrëveshjen e bashkëpunimit nr. 3242rep dhe nr. 1025/1kol, datë 19.09.2019 pika 3 paragrafi 3 në të cilin shprehet se palët bien dakord të bashkojnë kapacitet teknike, ekonomike-financiare, administrative-ligjore me qëllim plotësimin e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor si dhe të realizimit të kontratës së shërbimit në rast të shpalljes fitues.

Ne DT pika 9 e kapacitetit teknik, kerkohet qe: Operatori Ekonomikofertues duhet qe ne stafin tekmi te kete edhe 1 (nje) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektromk/Telekomunikacioni/Informatik/Kompjuterike/Megatronike. Per te vertetuar disponimin e këtij kapaciteti, operatori duhet te paraqesë Diplomen dhe Kontraten e Punes. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik cdo anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter ne te kundert perben kusht per s'kualifikim.

Ne VKM 914/2014, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publlk", Neni 74 bashkimi i operatoreve ekonomikë pika 3 thuhet: Secili prej anetareve te këtij bashkimi duhet te permbushë kërkesat ligjore, te parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara ne dokumentet e tenderit Kërkesat ekonomike,financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Referuar sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga OE "International Security Albania" sh.p.k. ne kontraten e bashkepunimit Nr.3242 rep dhe nr.1025/1 kol, date 19.09.2019·nuk eshte percaktuar se cilen pjese teknike do te kryej secili antare i bashkimit si dhe dokumentacioni per punonjesin Bekdash Cukalla eshte i pa sakte pasi eshte paraqitur certificate profesionale e nivelit te tretë dhe jo diplorne bachelor.

Per sa me siper, Komisioni i shqyrtimit te ankeses gjykon se pretendimi ankimuesit nuk qendron. Lidhur me pretendimet per mangesi ne dokumentacionin se BOE "Anakonda Security: sh.p.k dhe "Toni Security" sh.p.k., te kualifikuar, sqarojrne se pas verifikimit te dokurnentadonlt të paraqitur nga ky BOE rezulton se si vertetirni per armët e krahut e leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit,

Vertetimi i DVP Vlore dhe Deklarata per paraqitje te ofertës së pavarur (Shtojca 1/1), plotesojne kerkesat per kualifikim te kerkuara ne DT.

Per sa me siper, Komisioni i shqyrtimit te ankeses gjykon se pretendimi ankimuesit nuk qendron.

Perfundimisht per sa parashtruam me siper, mbeshtetur ne nenin 63 te ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe nenin 78, pika 6, germa c te V.K.M Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, Komisioni per Shqyrtimin e Ankeses, me unanimitet, vendosi: Te mos pranoje ankesen e BOE "Mandi 2K" sh.p.k & "International Security Albania" sh.p.k per tenderin me objekt: "Ruajtja me polici private te objekteve te KESH sh.a (Tirane, Vlore, Durres)".[...]

II.7. Në datën 01.11.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoriteti kontraktor me argumentat si më posht vijon:

[...]Boe “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., ka marrë pjesë në tenderin me objekt : “Ruajtja me polici private të objekteve të KESH sh.a (Tiranë, Vlorë Durrës”- Marrëveshje Kuadër –me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 36 muaj”, ku u paraqitëm ofertën e tyre me datë 23.09.2019. Në datën 15.10.2019 kemi marrë njoftimin nëpërmjet sistemit elektronik, ku KVO-ja n aka skualifikuar me pretendimin për të cilën po paraqesim kundështimet tona të argumentuara si më poshtë dhe me dokumentacionin përkatë bashkëngjitur:

Nga KVO-japretendohet se:

1. “Mandi -2K” sh.p.k. nuk ka paraqitur listëpagesaat për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga Administrata Tatimore.
2. Nuk ka qendër kontrolli në njësinë administrative ku është objekti.
3. Nuk ka në stafin teknik një punonjës të diplomuar në Barchelor për elektronik/telekominakacion /informatik/kompjuterik megatronikë.
4. Përsa më sipër pretendimet nuk qëndrojnë për arsyet e mëposhtme.:

Mbi themelin e ankimit

Vendimi për skualifikimin e ofertës tonë është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të dhëna nga ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në kundëshitim me kritret kualifikuese të parashikuara në DST të Miratuara me VKMnr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Vendimi për kualifikimin dhe skualifikimin e oer-ve pjesmarrës në një procedurë prokurimi është një akt administrativ në kuptim të nenit 98 të Kodit të Pr. Administrative. Gjithashtu akti administrativ për njoftimin e kriteretë kualifikimit të opearitorit ekonomik është akt i cili detyrimisht duhet të jetë i sqaruar në kuptim të nenit 100 të Kodit të Pr. Administrative, pasi ky prek interesa të ligjshëm të palës.Veprim i i mësipërm përveçse është rezultat i një procesi administrativ të kryer në kundëshitim me dispozitat e Kodit të Pr. Administrative, nuk respekton gjithashtu asnjë nga elementët e përcaktuara në nenet 98 e vijues të këtij kodi përsa i takon formës së aktit dhe arsytimit të tij.

Shoqëria “Mandi -2K” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së paraqiti Formularin e Ankesës pranë Autoritetit Kontraktor nr. 140 prot datë 18.10.2019 duke i konsideruar të pabazuara konstatimin e bërë nga KVO-ja , në lidhje me dokumentacionin kualifikues të paraqitur nga ne në këtë tender.

Më datë 24.10.2019 nr. 4379/3 Autoriteti Kontraktor KESH kthen përgjigje duke hedhur poshtë pretendimet tona në ankesën nr. 140 prot datë 18.10.2018.

Në këto kushte të mos pranimi të ankesës sonë nga AK-ja po ju drejtojmë me formularin përkatës së ankesë KPP-së me të njëjtat pretendime që gritëm ndaj KVO-së pranë Autoritetit Kontraktor.

Në fakt këto pretendime të ngritura nga KVO-ja e AK-së nuk qëndrojnë për arsye se ne kemi plotësuar me dokumenta të gjitha kriteret e kualifikimit të kërkuara, për të cilat japim sqarimet si më poshtë:

Së pari Nga ana jonë në spe është paraqitur vërtetimi për numrin e punonjësve të siguruar sic është kërkuar nga AK-ja me nr. Mesatar punonjësish për 60 veta për tremujorin e fundit Qershor, Korrik, Gusht duke vërtetuar disa herë më shumë numrin e të unësuarave nga sa është kërkuar nga AK-ja , vërtetim ky i marrë në mënyrë elektronike nga sistemi i Tatimeve në e-Albania ku vërtetohet se shoqëria “Mandi -2 K” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim si dhe numrin e punonjësve të deklaruar për cdo muaj. Përderisa vërtetimi është i rregullt dhe me numër punonjësish më shumë se sa ju keni kërkuar do të thotë se është bërë deklarimi i listëpagesave sipas afateve të parashikuara në ligj, si dhe pagesa në bankë për detyrimet sipas urdhërpagesës përkatëse që gjenerohet në sitin e tatimeve.gov.al pas deklarimit të listëpagesës.

Pra ne si operatorë subjekt juridik kemi deklaruar dhe derdhur për llogari të organit përkatës detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe mandatpagesat për të gjithë periudhën e këkuar në dokumentat standarte të tenderit që është periudha e kërkuar.

Në këtë kuptimreferuar dispozitave ligjore të sipërcituara për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitet teknike në lidhje me numrin e punonjësve , në ërputhje dhe në përpjestim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi, kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ekonomik shoqëria “Mandi -2 K” sh.p.k.

Sqarojmë se qëllimi i ak-së duhet të jetë verifikimi i kapaciteteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Përderisa përmbushja e kapaciteteve të mjaftueshme në rastin konkret fuqia punëtore, dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore provohen me anë të këtyre dokumentave, qëllimi final është realizuar për përmbushjen e këtij kriteri si dhe referuar vendimit KPP-së nr. 13/2013.

Gjithashtu referuar Vendimit 62/2016 ku është e njëjta arsye skualifikimi si në rastin objekt ankimi, ku ndër të tjera citohet se[...] referojmë vendimin[...].

Referuar arsyetimit të KPP-së përsa kohë shoqëria “Mandi -2K” sh.p.k. ka dorëzuar vërtetimin e nr të punësuarve ndërmjet të cilës vërtetohet se subjekti “Mandi -2 K sh.p.k. rezulton se për periudhën deri në datën 19.09.2019 nuk ka detyrime asnjë borxh tatimorë për TVSH , tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjera tatimesh. Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 23.09.2019 ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen e kapaciteteve në rastin konkret fuqia punëtore e shoqërisë “Mandi -2 K” sh.p.k. lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrime të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit. Referomë nenin 53 pika 3 e LPP-së[...].Vendimin nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar nenin 26 pika 8[...]

Në këtë kuptim për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitet e dhura për kontratën dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitete dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Përsa më sipër ju argumentuam se arsyeja e parë e skualifikimit nuk qëndron.

Së dyti;

Arsye e dytë e skualifikimit është se nuk ka qëndër kontrolli në njësinë administrative ku është objekti, kundështojmë këtë arsye si të pabazuar në ligj.

Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron pasi funksionimi i kompanive SHPSF bëhet mbi bazë qarku sipas Udhëzimit nr. 130 datë 05.03.2018 Për funksionimin e SHPSFgërma “d” pika 5 thotë se miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë. Pra funksionimi i subjekteve SHPSF organizohet mbi bazë qarku dhe nuk është e nevojshme të ketë qëndër kontrolli në cdo qytet njësi administrative, pothuajse të ketë të miratuar qëndër e kontrollit brenda territorit të Qarkut.

Për sa më sipër kemi plotësuar kriterin pasi shoqëria “Mandi -2K” sh.p.k. ka paraqitur Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit me seli në njësinë administrative Sarandë që është nën juridiksionin e Qarkut Vlorë, ky akt i miratimit i qendrës së kontrollit është bërë nga Drejtuesi i Parë i DPQ Vlorë.

Për sa më sipër argumentuam se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron pasi është e pabazuar në ligj dhe është arsye skualifikimi tendencioze duke cënuar haptazi barazionë në tendera dhe prokurimet publike.

Së treti: Përsa i përket arsyes se nuk ka në stafin një punonjës të diplomuar në Bachelor për elektronik/telekomunikacion/informatik/kompjuterike/megatronike ndonëse Shoqëria tjetër e BOE “I.S.A.” sh.p.k. e plotëson këtë kusht, në akt marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorit ekonomik nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këtë shërbim për të dyja shoqëritë e bashkimit.

Përsa më sipër ju sqarojmë se në Akt-Marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. 3242rep dhe nr. 1025 kol datë 19.09.2019 e paraqitur në spe në pikën 3 paragrafi 3 citohet shprehimisht se:

Palët bien dakord të bashkojnë kapacitetet teknike, ekonomiko-financiare, administrativo-ligjore me qëllim plotësimin e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor si dhe të realizimit të kontratës së shërbimit në rast shpalljes fitues.

Pra pretendimi i juaj në arsyen e skualifikimit se ndonëse shoqëria tjetër e BOE-së “I.S.A.” sh.p.k. e plotëson këtë kusht në akt marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorit ekonomik nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këtë shërbim për të dyja shoqëritë e bashkimit është i pavërtetë dhe i pabazuar në dokumenta.

BOE Shoqëria “Mandi 2K” sh.p.k. dhe shoqëria “I.S.A.” sh.p.k. e ka përmbushur këtë kriter pasi sipas përcaktimeve që ju vetë si KVO keni bërë. Për sa më sipër argumentuam se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

Së katërti: Nga vlerësimi i bërë nga KVO rezulton se është kualifikuar oe “Anakonda Security” sh.p.k. kundështojmë kualifikimin e këtij operatori ekonomik pasi nuk plotëson kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 8 nën pika 7 ku kërkohet:

Ka jo më pak se 2 armë brezi dhe 1 armë krahu.

Operatori ekonomik “AnakondaSecurity” sh.p.k. nuk përmbush këtë kriter pasi nuk disponon armë krahu e deklaruar në sistem SIMA të vërtetuar nga DVP Vlorë.

Përsa më sipër argumentuam arsyen se operatori ekonomik “AnakondaSecurity” sh.p.k. duhet skualifikuar.

Së pesti: Nga vlerësimi i bërë i KVO-së rezulton se është kualifikuar operatori ekonomik “AnakondaSecurity” sh.p.k. kundështojmë kualifikimin e këtij oe-je pasi nuk plotëson kriterin 2. Kriteret

e vecanta të kualifikimit 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë gërma “b” deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas shtojcës 1/1.

Opearatori ekonomik nuk ka plotësuar saktë deklaratën për paraqitje oferte të pavarur pasi në pikën 6 nuk ka plotësuar gërmën “b” pasi ky operator konkuron si bashkim operatorësh ekonomik në këtë procedurë. Opearatori ekonomik “AnakondaSecurity” sh.p.k. duhet të kishte cekuar gërmën “b” pika 6 tek deklarata për paraqitjetë pavarur.

Përsa më sipër argumentuam arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Anakonda Security” sh.p.k. Përsa më sipër argumentuam në zbatim të kërkesave të LPP-së [...] si dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 e ndryshuar dhe DST kërkojmë nga KPP:

Pezullimin e vazhdimin të procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht.

Rivlerëimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Mandi -2K” sh.p.k. & “I.S.A.” sh.p.k., kualifikimin e saj.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “AnakondaSecurity” sh.p.k.

Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga BOE “Mandi -2K” sh.p.k. & “I.S.A.” sh.p.k.,[...].

II.8. Nëpërmjet shkresës nr5234/1 prot., datë 11.11.2019, protokolluar me tonën në datën 12.11.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

passhqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1.Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., për vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[..OE “Mandi 2K” sh.p.k. nuk plotëson kriterin 4 të kapaciteteve teknike 3.3 në të cilin kërkohet: “Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar, jo më pak se 25 punonjës, (punonjës sherbimi, grup te gatshem, Titullar dhe Drejtues teknik te shoqerise). Per te vertetuar kete kriter duhet te paraqiten Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik- Gusht 2019”, pasi OE “Mandi 2K” sh.p.k nuk ka paraqitur Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik-Gusht 2019. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.3.3, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, pika 4 në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar, jo më pak se 25 punonjës, (punonjës shërbimi, grup te gatshëm, Titullar dhe Drejtues teknik te shoqërise). Per te vertetuar kete kriter duhet te paraqiten Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik- Gusht 2019. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga sejcili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi..

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Mandi -2K” sh.p.k. si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k.,ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin e mëposhtëm:

Vërtetim “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Ttatimpaguesin –eSig02/a”, nr.T01390952., datë 19.09.2019, marrë në mënyrë elektronike nga sistemi i tatimeve në e-albania.

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 parashikohet se “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

III.1.5. Në nenin 28, pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, si dhe shtojcës mbi modifikimin e kriterëve të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë jo më pak se 25 punonjës, (punonjës shërbimi, grup të gatshëm, Titullar dhe Drejtues teknik të shoqërisë). Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqiten Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik- Gusht 2019. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Mandi -2K” sh.p.k., rezulton se ky i fundit, ka paraqitur Vërtetim “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Ttaticpagesin –e Sig02/a, marrë në mënyrë elektronike nga sistemi i tatimeve në platformën e-albania. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik “Mandi -2K” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit, nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, Listpagesat E-SIG 25 shoqëruar me Formularët e Deklarimit përkatës për muajt Qershor-Korrik- Gusht 2019”, por ka paraqitur vetëm Vërtetimin “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Ttaticpagesin –eSig02/a. të marrë nga sistemi i tatimeve në platformën e-albania, në kundërshtim me kërkesën eksplicite të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Mandi -2 K” sh.p.k. si anëtarë i bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ky i fundit nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 3.3.g “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, i ndryshuar me shtojcën përkatëse. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., për vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[..- OE “Mandi 2K” sh.p.k., nuk plotëson kriterin 9 të kapaciteteve teknike 3.3 në të cilin kërkohet: “Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 1 (një) punonjës i diplomuar në bachelor për Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Për të vërtetuar disponimin e këtij kapaciteti, operatori duhet të paraqesë: Diplomen dhe Kontraten e Punës. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s’kualifikim” pasi ky operator ekonomik, për

punonjësin Bekdash Cukalla, nuk ka paraqitur diplomë bachelor por nje diplomë te shkolles se mesme profesionale “Antoni Athanas” ne Sarande dhe, me kete dokument, nuk plotësohet kërkesa per kualifikim. Ndonese shoqëria tjeter e bashkimit te operatoreve ekonomike “International Security Albania” e plotëson kete kusht, ne akt marreveshjen e bashkepunimit midis dy OE “Mandi 2K” sh.p.k dhe “International Security Albania” nuk eshte specifikuar qe kjo shoqëri do te kryeje kete shërbim per te dyja shoqëritë e bashkimit.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3.3, të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, pika 9 në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 1 (një) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punës. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s’kualifikim.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi -2K” sh.p.k. & “Internacional Security Albania” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, ndërmjet shoqërisë “Mandi 2K” sh.p.k dhe shoqërisë “Internacional Security Albania” sh.p.k., në të cilën ndër të tjera parashikohet se: [....] Përqindja e pjesmarrjes është :

60% “Mandi-2K” sh.p.k.

40% “Internacional Security Albania” sh.p.k.

Shërbimi konkretisht për secilin anëtar është:

Për shoqërinë “Mandi -2K” sh.p.k. merr përsipër shërbimin në objektin :

Tec Vlora- 3(tre) vendroje me 4.98 (katër pikë nëntëdhjetë e tetë) punonjës shërbimi për cdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e Hëna në të Djelë.

Për shoqërinë “Internacional Security Albania” sh.p.k merr përsipër shërbimin në objektet:

SL-Durrës 1(një) vendroje me 4.98 (katër pikë nëntëdhjetë e tetë) punonjës shërbimi për cdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e Hëna në të Djelë.

Zyrat Qëndrore KESH sh.a.- 1(një) vendroje me 4.98 (katër pikë nëntëdhjetë e tetë) punonjës shërbimi për cdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e Hëna në të Djelë.

Në Prokurën e Posaçme datë 19.09.2019 është deklaruar se Prokurë e Posaçme ku deklarohet se shoqëria “Mandi - 2K” sh.p.k. është shoqëria përfaqësuese në këtë bashkim.[...]

II.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi -2K” sh.p.k. & “Internacional Security Albania” sh.p.k. konstatohet se, shoqëria “Mandi -2K” sh.p.k. “si pjesë e bashkimit në plotësimin të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

Çertifikatë Profesionale e Nivelit të tretë, Z. B.C., lëshuar Shkolla e Mesme Profesionale Teknike Ekonomike dhe Hoteri Turizëm “Antoni Athanas”.

Diplomë e maturës shtetërore

Kartë identiteti Z. B.C.

Çertifikatë Profesionale e Nivelit të parë, Z. B.C., lëshuar Shkolla e Mesme Profesionale Teknike Ekonomike dhe Hoteri Turizëm “Antoni Athanas”.

Kontratë pune individuale lidhur ndërmjet punëdhënësit “Mandi-2K” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z.B.C.

III.2.4. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtui, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.2.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.6. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe

i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Konkretisht, dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike për plotësimin e kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi nga operatori ekonomik “Mandi -2K” sh.p.k. si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, e si rrjedhim nuk konsiderohet i vlefshëm. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në lidhje me pretendimin e ankimesit se “*[...]Pra pretendimi i juaj në arsyen e skualifikimit se ndonëse shoqëria tjetër e BOE-së “I.S.A.” sh.p.k. e plotëson këtë kusht në akt marrëveshjen e bashkëpunimit midis operatorit ekonomik nuk është specifikuar që kjo shoqëri do të kryejë këtë shërbim për të dyja shoqëritë e bashkimit është i pavërtetë dhe i pabazuar në dokumenta. BOE Shoqëria “Mandi 2K” sh.p.k. dhe shoqëria “I.S.A.” sh.p.k. e ka përmbushur këtë kriter pasi sipas përcaktimeve që ju vetë si KVO keni bërë. Për sa më sipër argumentuam se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.[...]*” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përputhje me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar plotësimin e kriterit të vecantë të kualifikimit të parashkuar në pikën 9 të “Kritereve të Vecanta të kualifikimit” kanë patur barrën për të vërtetuar disponimin e tij (1 (një) punonjësi të diplomuar në bachelor për Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike) referuar shërbimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Mandi -2K” sh.p.k. si pjesë e bashkimit është në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të vecanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, sipas kontratës së bashkëpunimit, në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: *“Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania”

sh.p.k., nuk përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e s'kualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k. mbi ofertën e operatorit ekonomik “Anakonda Security” sh.p.k. në procedurën e mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, e bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k. mbeten të skualifikuar në bazë të arsyetimit të KPP-së, pra trajtimi i pretendimeve të tyre në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar pretendimi mbi skualifikimin e tyre të padrejtë. Rrjedhimisht, në kuptim të ligjit, interesi i tyre i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për rrjedhojë, këto pretendime nuk merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Mandi 2K” sh.p.k. & Internacional Security Albania” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-34123-08-22-2019, me objekt : “Ruajtja me polici private të objekteve të KESH sh.a (Tiranë, Vlorë Durrës”- Marrëveshje Kuadër –me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –me afat 36 muaj” me fond limit 57.748.099 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.09.2019 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjetiko Shqiptare).
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1697 Protokolli

Datë 01.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha